



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA – VLADA – GOVERNMENT

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

DOSJA E TENDERIT

“PROCEDURA PËR KUOTIMIN E ÇMIMEVE” [FURNIZIM/SHËRBIME/PUNË] VLERA TË VOGLA

Data kur është përgatitur Dosja e Tenderit:

<07.09.2010 >

Nr. i prokurimit ⁴	P.K. 214	10	07	2 / 3 /6
-------------------------------	----------	----	----	----------

Titulli: < Mirembajtja vjetore e sistemit të mbrojtjes kunder zjarrit inergen për Laboratorin e Forenzikes të P.K.-së >

KJO DOSJE E TENDERIT PERBEHET PREJ TRI PJESËVE:

Pjesa A: Informacione për tenderuesit për përgatitjen e kuotimit;

Pjesa B: Draft Kontrata që përmban kushtet kontraktuese të cilat duhet t'i pranojë tenderuesi që merr kontratën; dhe

Pjesa C: Formulari i Tenderit, dmth. dokumentet që duhet t'i paraqesin tenderuesit.

Në bazë të nenit 35 të Ligjit nr. 02/L-99, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë i amendamentuar me Rregulloren nr. 2007/20

⁴ Të raportohet në çdo dokument në lidhje me aktivitetin e prokurimit

[DOSJA STANDARDE E TENDERIT PËR PROCEDURËN PËR KUOTIM TË ÇMIMEVE
[FURNIZIM/SHËRBIME]

VLERA TË VOGLA

KËRKESA PËR KUOTIM TË ÇMIMEVE

<Prishtinë,07.09.2010 >

< Emri dhe adresa e tenderuesit potencial >
Ref. jonë: < P.K.214/10/07/236 >

I/E nderuar(a) [Z/Znj] <Emri i kontaktit >

**Titulli: Mirembajtja vjetore e sistemit të mbrojtjes kunder zjarrit inergen për
Laboratorin e Forenzikes të P.K.-së**

Ju ftojme të dorëzoni kuotimin tuaj të çmimeve për [furnizimet] [shërbimet] siç është dhënë në Dosjen e bashkangjitur të tenderit, neni II.

Kontrata që mund të rezultojë nga kjo financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në Euro.

Kuotimi juaj në formatin e kërkuar (Formulari për Kuotim të Çmimeve) duhet të adresohet dhe të dorëzohet bashkë me dokumentet tjera të kërkuara sipas nenit IV të Dosjes së Tenderit.

Nga ju pritët t'i kontrolloni me kujdes të gjitha pjesët dhe nenet e Dosjes së Tenderit si dhe anekset e saj, dhe të veproni sipas të gjitha kërkesave, specifikimeve dhe kushteve që i përmban ajo.

Ne, si Autoritet Kontraktues nuk do të pranojmë asnjë modifikim.

Asnjë shpenzim që e bëni gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kuotimit të çmimit nuk do të ju kompensohet.

Ne e mirëpresim marrjen e kuotimit tuaj të çmimeve.

Nëse keni nevojë për informata plotësuese apo sqarime që të përgatisni dhe dorëzoni kuotimin tuaj të çmimeve, ju lutem vazhdoni siç është dhënë në paragrafin IV.1 të Dosjes së Tenderit.

Nëse vendosni të mos dorëzoni kuotim çmimesh, do të jemi mirënjohës nëse mund të na informoni me shkrim, duke i paraqitur arsyet e vendimit tuaj.

Me respekt,

Emri dhe Mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

TABELA E PËRMBAJTJES

A. INFORMACIONE PËR TENDERUESIT	4
NENI I IDENTIFIKIMI I AUTORITETI KONTRAKTUES	4
I.1 EMRI ZYRTAR DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES	4
NENI II LËNDA E KONTRATËS. KUSHTET E KONTRATËS	4
II.1) TITULLI I KONTRATËS.....	4
II.2.1) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP).....	4
II.2.2) Afatet dhe kushtet materiale, natyra, fushëveprimi, niveli, sasia [sipas nevojës].....	5
II.2.4) Specifikimet teknike të detyrueshme	5
II.3) KËRKESAT E DËRGESËS	5
II.3.2) VENDI (VENDET) E DËRGESËS SË [FURNIZIMEVE] [SHËRBIMEVE].....	5
II.4) KËRKESAT GARANCISË.....	5
II.5) KUSHTET EKZEKUTIMIT.....	5
II.6) [KUSHTET TJERA KONTRATËS].....	5
NENI III KËRKESAT QË DUHET TË PLTËSOHEN NGA OPERATORËT EKONOMIK... ..5	
III.1) KRITERET E PËRZGJEDHJES.....	5
III.1.2) PËRSHTATSHMËRIA E OPERATORËVE EKONOMIK.....	5
III.2) KËRKESAT MBI PËRSHTATSHMËRINË PROFESIONALE (sipas nenit 62 të ligjit).....	7
III.3) KËRKESA TJERA KUALIFIKIMI (sipas nenit 63 dhe 64 të ligjit).....	7
KUSHTET E KUOTIMIT TË ÇMIMEVE.....	7
NENI IV INFORMATAT SHITESË KUSHTET E TENDERIMIT HAPJA E TENDERËVE	7
IV.1) AFATI KOHOR PËR PRANIMIN E KËRKESAVE PËR INFORMATA SQARUESE.....	8
IV.2) AFATI KOHOR DHE VENDI PËR DORËZIMIN E KUOTIMIT TË ÇMIMEVE.....	8
IV.3) VALUTAT - LLOGARITJA E ÇMIMEVE.....	8
IV.4) FORMULARI I KUOTIMIT TË ÇMIMEVE. LISTA E DOKUMENTEVE TË KËRKUARA.....	8
IV.5) PERIUDHA E VLEFSHMËRISË SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT	9
NENI V TË ÇMIMIT KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS – VLERËSIMI I KUOTIMIT 9	
V.1) KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS.....	9
V.2) VLERËSIMI I KUOTIMIT TË ÇMIMEVE.....	9
V.2.1) KORIGJIMI I GABIMEVE ARITMETIKE.....	9

NENI		VII
ANKESAT	10	
VI.2) PERIUDHA KOHORE PËR DORËZIMIN E ANKESËS PRANË OSHP-së.....	10	
NENI VIII	PJESËT E BASHKANGJITURA:	11
ANEKS 1.	SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME.....	12
ANEKS 2.	KËRKESAT E PËRSHTATSHMËRISË DEKLARATA NËN BETIM	13
ANEKS 3.	KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË.....	15
ANEKS 4.	KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS (tenderi ekonomikisht më i favorshëm).....	16
B DRAFT KONTRATA		17
C. FORMULAR TENDERI PËR KONTRATË [FURNIZIMI] [SHËRBIMI]		20
1.	LISTA E DOKUMENTEVE QË KËRKOHEN	21
2.	PËRSHKRIMI I ÇMIMIT.....	22

PJESA A: INFORMACIONE PËR TENDERUESIT

Në tërë këtë dosje të tenderit ju referohemi me “operator ekonomik” ose me “tenderuesi”.

Lëshuesit të kësaj dosjeje të tenderit i referohemi si “autoritet kontraktues”.

Bazë ligjore e kësaj Procedure për Kuotimin e Çmimeve është Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 02/I-99, i cili është amendamentuar me Rregulloren Nr.2007/20 e cila ka hyrë në fuqi me 06 qershor 2007,(në vazhdim të tekstit: Ligji).

Operatorët ekonomik të cilit dëshirojnë të dorëzojnë kuotimin e çmimeve, si dhe autoriteti kontraktues, duhet të respektojnë kërkesat që rrjedhin nga ky ligj dhe Rregullat e Prokurimit Publik të nxjerra në përputhshmëri me të. Nga operatorët ekonomik të cilit dëshirojnë të dorëzojnë kuotimin e çmimeve, pritet që të ekzaminonjë me kujdes të gjitha pjesët e kësaj dosjeje të tenderit dhe anekset e saj dhe të pajtohen me të gjitha kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përfshira këtu.

Ju duhet të kuotoni të gjithë artikujt e specifikuar në këtë Dosje të Tenderit. Duhet të ofroni një **çmim fiks të shumës së plotë** në Euro, duke përfshirë të gjitha tatimet dhe detyrimet e zbatueshme si dhe ndonjë ngarkesë apo taksë të transportimit, sigurimit, instalimit ose ngarkesa apo taksa tjera.

Kuotimet e çmimeve do të vlerësohen për të gjithë artikujt së bashku dhe kontrata i jepet operatorit ekonomik që e ofron tenderin më të mirë në pajtim me kriteret e dhënies së kontratës që janë të parapara në Dosjen e Tenderit, paragrafi V.1).

Asnjë modifikim nuk pranohet nga autoriteti kontraktues.

Kuotimi i çmimeve i cili nuk është dorëzuar pranë autoritetit kontraktues brenda afatit të specifikuar në paragrafin IV.2 të Dosjes së tenderit dhe/ose nuk është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë dosje tenderi, do të refuzohet dhe do të konsiderohet si kuotim “i pa përgjegjshëm”.

Në dorëzimin e tenderit, tenderuesi, pranon plotësisht dhe pa kufizime kushtet e veçanta dhe të përgjithshme që rregullojnë këtë kontratë si një bazë të vetme e kësaj procedure tenderuese, pavarësisht nga kushtet e tij ose të saj të shitjes, nga të cilat ai/ajo me këtë rast heq dorë.

Të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe me dorëzimin e kuotimit të çmimeve duhet të barten nga tenderuesi, ndërsa autoriteti kontraktues nuk do të ketë asnjë detyrim në rast se anulohet procedura.

Në dorëzimin e kuotimit të çmimeve, tenderuesi, pranon plotësisht dhe pa kufizime kushtet që rregullojnë këtë kontratë si një bazë të vetme e kësaj procedure tenderuese, pavarësisht nga kushtet e tij ose të saj të shitjes, nga të cilat ai/ajo me këtë rast heq dorë.

NENI I IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

I.1 EMRI ZYRTAR DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Emri i AK:	<Policia e Kosovës >		
Adresa e AK:	<Luan Haradinaj, Prishtinë >		
Adresa elektronike:	<www. Kosovopoliice.com>	Qyteti dhe Kodi postar:	<Prishtinë, 10000 >
Personi kontaktues:	Jakup Sermahaj	E-maili:	<jakup.sermahaj@kosovopoliice.com >
Telefoni	<038/5080 1105 >	Faksi:	<038/5080-1102 >

(Kuotimet e çmimeve duhet të dorëzohen në adresën e autoritetit kontraktues si më lart.)

NENI II LËNDA E KONTRATËS

II.1 TITULLI I KONTRATËS

Mirembajtja vjetore e sistemit të mbrojtjes kunder zjarrit inergen për Laboratorin e Forenzikes të P.K.-së

II.2 PËRSHKRIMI I LËNDËS SË KONTRATËS

II.2.1) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

6000000-8

II.2.2) Afatet dhe kushtet materiale, natyra, fushëveprimi, sasia [sipas nevojës].

II.2.3) Lënda e kontratës është [dërgesa] [instalimi] [mirëmbajtja] [shërbimi pas-shitjes] nga operatori ekonomik furnizues i [mallrave] [shërbimeve] në vijim:

Pjesa	Përshkrimi	Fushëveprimi	Sasia
1	Mirembajtja vjetore e sistemit të mbrojtjes kunder zjarrit inergen për Laboratorin e Forenzikes të P.K.-së	Sherbim	15

Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë një kuotim çmimesh për të gjithë artikujt.

II.2.4) Specifikimet e detyrueshme teknike

[Furnizimet] [shërbimet] duhet të jenë plotësisht në pajtim me specifikimet teknike të dhëna në këtë Dosje Tenderi, si në vijim:

<shëno specifikimet teknike, ose referoju në Aneks 2>

II.3) KËRKESAT E DËRGESËS

II.3.1) Vendi (vendet) e dërgesës së [furnizimeve] [shërbimeve]:

<Laboratori i Forenzikes, Zona industriale, Prishtinë >

II.3.2) Afati kohor për [dorëzimin ose fillimin dhe/ose përfundimin] e kontratës:

<30 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontrates >

II.4) KËRKESAT E GARANCISË

[Furnizimet e ofruara do të mbulohen me garancinë e operatorit ekonomik/prodhuesit për së paku 12 muaj nga data e dorëzimit të Autoritetit kontraktues] - [ose shëno ndonjë kusht tjetër të garancisë]

II.5) KUSHTET E EKZEKUTIMIT

[Autoriteti kontraktues mund të anulojë kontratën nëse operatori ekonomik nuk arrin të dorëzojë furnizimet/shërbimet në pajtim me kërkesat dhe kushtet e specifikuara në nenin II të kësaj Dosjeje të Tenderit, megjithë njoftimin paraprak 21 ditë përpara të dhënë nga ana e Autoritetit Kontraktues, pa shkaktuar asnjë detyrim të operatorit ekonomik] - [ose shëno ndonjë kusht tjetër të ekzekutimit]

II.6) [KUSHTET TJERA TË KONTRATËS:]

[sipas nevojës]

NENI III KËRKESAT QË DUHET TË PLOTËSOHEN NGA OPERATORËT EKONOMIKË QË DËSHIROJNË TË DORËZOJNË KUOTIMIN E ÇMIMEVE

III.1) KRITERET E PËRZGJEDHJES

III.1.2) PËRSHTATSHMËRIA E OPERATORËVE EKONOMIK (në bazë të Nenit 61 të ligjit):

- 1. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i tij/saj:**
 - a) ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues; ose
 - b) ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të këtyre të fundit.

- 2. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ose ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të fundit:**
 - a. është dënuar nga një gjykatë kompetente për veprë penale duke përfshirë të praktikuarit e korrupsionit, larjen e parave, mitosje, shantazh ose aktivitetet e përshkruara ose të ngjashme me ato të përshkruara në nenin 117.1 të Ligjit, në ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë ose në cilindo vend, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;
 - b. është deklaruar i papërshtatshëm, për shkak të sjelljeve të përmendura më lart, nga çfarëdo banke, institucioni ose organizate e cila ofron fonde për zhvillim të përgjithshëm, investim publik ose rindërtim;
 - c. është dënuar nga një gjykatë kompetente për veprën penale të pjesëmarrjes në aktivitetet e një organizatë kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose si të kundërligjshme; ose
 - d. është dënuar nga një gjykatë kompetente për veprë penale të mashtrimit ose të barabartë me mashtrimin;
 - e. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale; ose
 - f. është konstatuar nga OSHP-ja apo nga ndonjë gjykatë kompetente se ka bërë keq-interpretime para ndonjë autoriteti publik në Kosovë apo diku tjetër;

- 3. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operator ekonomik:**
 - (a) Gjatë dy viteve të fundit, është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar, ose insolvent; me vendim të një gjykate kompetente, apo është aktualisht objekt procedure: (i) për tu shpallur i bankrotuar, (ii) për urdhër për likuidim ose është vënë në mbikëqyrje të administratorit nga gjykata kompetente;

- (b) Me vendim të një gjykate kompetente është likuiduar ose është vënë në mbikëqyrje të administratorit;
- (c) Aktualisht ka një marrëveshje ose aranzhim me kreditorët e tij, që siguron kushte të zgjeruara ose të reduktuara të pagimit, nëse mbi kushtet e tilla janë pajtuar paraprakisht kreditorët e tillë për shkak se operatori ekonomik më parë ka qenë i paafte që të përmbushë obligimet e tij në afatin e duhur kohor;
- (d) Është në një situatë të ngjashme me ato të përshkruara në a, b, ose c më lartë, që rrjedhin nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve në vendin ku është themeluar ose në vendin ku zhvillon veprimtarinë e tij afariste;
- (e) Aktualisht i nënshtrohet një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon pagesat nga ose për një operator të tillë ekonomik dhe që rezultojnë në një humbje të tërësishme ose të pjesshme të të drejtave të operatorit ekonomik për të administruar ose disponuar me pasurinë e tij;
- (f) Aktualisht është objekt i një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili pezullon ose redukton pagesat nga ose për operatorët e tillë ekonomik, apo nëse procedurat e tilla gjithashtu mund të rezultojnë me vendim për falimentimin ose likuidimin e operatorit ekonomik;
- (g) Gjatë tri viteve të fundit është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur ndonjë kontratë me ndonjë njësi publike, autoritet publik ose ndërmarrje në Kosovë, apo gjetiu;
- (h) Aktualisht është vonuar më shumë se tridhjetë (30) ditë me pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurimin social në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, apo është vonuar me pagimin e borxheve ndaj operatorëve të shërbimeve publike në Kosovë për ujë, rrymë, gas apo ngrohje;
- (i) Aktualisht është vonuar në pagimin e tatimeve në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose
- (j) Ende nuk ka vepruar në pajtim me ndonjë vendim të lëshuar nga OSHP-ja ose ndonjë panel shqyrtues;
- (k) Ka një vendqëndrim afarist në Kosovë, por nuk ka certifikatë valide të regjistrimit të lëshuar nga Regjistri i Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtar në Kosovë.

Periudhat kohore të përcaktuara në këtë nen, ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprind datën e publikimit të njoftimit të kontratës ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim.

4. Operatori ekonomik, për ta provuar se është i përshtatshëm për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, ose në ekzekutimin e kontratës, duhet t'i dorëzojë këto dëshmi të dokumentuara:

- a) Për situatën, të cilës i referohet pika 1 a) dhe b) deklaratë me shkrim dhe e nënshkruar nga tenderuesi në formularin e bashkëngjitur në ANEKS 2.
- b) Për situatën, të cilës i referohet pika 2 a), c), d) dhe pika 3 a), b) dhe d), një dëshmi nga autoriteti kompetent gjyqësor apo autoriteti administrativ i shtetit të themelimit të tenderuesit.
- c) Për situatën të cilës i referohet pika 3. h) dhe k) një dëshmi e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik e cila dëshmon se një situatë e tillë nuk ekziston. Dëshmitë lidhur me pikën 3 h) dhe k) mund të kërkohen nga kandidati ose tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues synon të i'a japë kontratën. Këto dokumente duhet të paraqiten nga ana e kandidatit ose tenderuesit para dhënies së kontratës. Në mungesë të njëres nga këto dokumente, kontrata nuk do t'i ipet.
- d) Për situatën të cilës i referohet pika 3. i) një dëshmi nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë], [para datës së dorëzimit të ftesës për pjesëmarrje ose tenderim].

Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 61 të Ligjit si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.

III.2) Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale (sipas nenit 62 të Ligjit):

- a. Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik është i përshtatshëm, duhet t'i dorëzojë Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik.
- b. [Nëse objekt i aktivitetit të prokurimit është një kontratë publike e cila përfshinë kryerjen e shërbimeve profesionale, dhe nëse shërbimet e tilla janë të atij lloji që mund të sigurohen nga një tenderues i cili mbanë një autorizim apo licencë nga një autoritet publik apo i cili është anëtar i një organizate të caktuar] një kopje të certifikatës, të vërtetuar me nënshkrimin e tenderuesit, nga organi administrativ kompetent përgjegjës për testimin e përshtatshmërisë profesionale apo licencave.

Dëshmitë e dokumentuara në vijim:

[shëno dëshmitë:]

III.3) KËRKESA TJERA KUALIFIKIMI (sipas nenit 63 DHE 64 të Ligjit, *nëse zbatohet*):

[shëno ndonjë kërkesë kualifikimi lidhur me gjendjen ekonomike ose financiare:]

[shëno ndonjë kërkesë kualifikimi lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale]

Në të gjitha rastet, kur dorëzoni kuotimin tuaj, do të konsiderohet se ju keni pranuar mundësinë e sanksioneve penale dhe civile, dënimeve dhe gjobave, nëse ju, me dashje ose nga pakujdesia, dorëzoni dokumente, deklarata ose raporte që përmbajnë informacione të rreme ose keqinformuese.

KUSHTET E KUOTIMIT TË ÇMIMEVE

Nuk mund të bëhen negociata ndërmjet autoritetit kontraktues dhe operatorëve ekonomik lidhur me asnjë kusht material apo aspekt material të kuotimit të çmimit, as para, dhe as pas dorëzimit të kuotimit të çmimit.

NENI IV INFORMATAT SHITESË

IV.1) AFATI KOHOR PËR PRANIMIN E KËRKESAVE PËR INFORMATAT SHITESË OSE PËR INFORMATAT SQARUESE

Operatorëve ekonomik u lejohe të bëjnë **kërkesë me shkrim**, për të kërkuar nga autoriteti kontraktues informata sqaruese ose shitesë që mendojnë se janë të nevojshme për përgatitjen dhe për dorëzimin e Kuotimit të Çmimit të përgjegjshëm. Kërkesa e tillë duhet të pranohet nga autoriteti kontraktues, sipas nenit 51.1 të Ligjit, jo më vonë se:

Data: <10.09.2010>

Kërkesa në fjalë mund të behët me anë të përdorimit të formularit për kërkesë (Aneks 3) dhe mund t'i dorëzohet autoritetit kontraktues në mënyrë elektronike, me shkrim ose me telefaks.

Çdo sqarim i dosjes së tenderit do të komunikohet njëkohësisht me shkrim të gjithë tenderuesve.

IV.2) AFATI KOHOR DHE VENDI PËR DORËZIMIN E KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Kuotimet e çmimeve do të pranohen nga autoriteti kontraktues jo më vonë se:

Data:	<(16.09.2010)>	Koha:	<15:00 >	Vendi:	<Policia e Kosovës,Zyrja e Prokurimit kati i dytë B-202, ,Rr:Luan Haradinaj,Prishtinë >
--------------	----------------	--------------	----------	---------------	---

Kuotimi i çmimit që dorëzohet pas afatit të fundit për dorëzimin e kuotimeve të çmimeve, siç ceket më lartë në këtë paragraf IV.2), menjëherë do t'i kthehet e pa hapur, operatorit ekonomik.

Operatorët ekonomik mund të dorëzojnë vetëm një kuotim çmimesh dhe nuk mund të bëjnë asnjë ndryshim në kuotimin e dorëzuar të çmimeve.

IV.3) VALUTAT - IIOGARITJA E ÇMIMEVE

Të gjitha çmimet e specifikuar në Kuotimin e Çmimit duhet të deklarohen në Euro (€) dhe duhet të përfshijnë të gjitha taksat, obligimet dhe detyrimet tjera të aplikueshme.

IV.4) FORMULARI I KUOTIMIT TË ÇMIMEVE. LISTA E DOKUMENTEVE TË KËRKUARA

Kuotimet e çmimeve do të përgatiten duke përdorur formularin e kuotimit të çmimit i cili gjendet në pjesën C të kësaj Dosje të Tenderit.

Kuotimi i çmimit që duhet të dorëzohet përbëhet nga formulari i kuotimit të çmimit i plotësuar dhe i nënshkruar bashkë me dokumentet tjera që kërkohen, të plotësuara dhe të nënshkuara në mënyrën e duhur.

Lista e dokumenteve të kërkuara është e përfshirë në pikën 1, të Formularit të dorëzimit të Kuotimit i cili gjendet në pjesën C të kësaj dosjeje të tenderit. Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të sigurohen, të plotësuara dhe të nënshkuara në mënyrë të qartë, për të formuar një Kuotim valid të Çmimit.

Kuotimet duhet të jenë në përputhshmëri me kushtet në vijim:

- (i) Të gjitha kuotimet e Çmimit duhet të dorëzohen në një origjinal, të vendosur në një zarf të veçantë të shënuar “**ORIGJINAL**”, dhe kopje të nënshkuara në të njëjtën mënyrë sikur origjinali dhe të vendosura secila në një zarf të veçantë të shënuar “**KOPJE**”. Operatori Ekonomik duhet të shënojë **Numrin e Prokurimit** (shih faqen e parë të kësaj dosjeje të tenderit), **emrin dhe adresën e Operatorit Ekonomik** në faqen e përparme të secilit nga zarfet. Zarfet pastaj duhet të mbyllën në një zarf të jashtëm që tregon vetëm:
 - a. Adresën e autoritetit Kontraktues ku duhet të dorëzohen Kuotimet e Çmimeve (të caktuar në paragrafin I.1 dhe IV.2 të kësaj Dosje të tenderit);
 - b. Numrin e Prokurimit (shih faqen e parë të kësaj dosjeje të tenderit)
 - c. fjalët “**Mos e hap përpara**” <16/09/2010 >.orës 15:00
 - d. Emrin e tenderuesit.
- (ii) Një nga kopjet e dorëzuara duhet të mbahet e pa hapur nga ana e autoritetit kontraktues për OSHP-në, si provë në rast të ndonjë pretendimi për përmbajtjen e Kuotimit të Çmimit.

[Çdo specifikim tjetër në lidhje me dorëzimin e Kuotimeve (specifiko):]

IV.5) PERIUDHA E VLEFSHMËRISË SË KUOTIMIT TË ÇMIMEVE

Kuotimet e çmimeve do të jenë të vlefshëm për: <30 > ditë kalendarike, nga data e fundit e paraparë në paragrafin IV.2 të kësaj dosje të tenderit për dorëzim të kuotimeve të çmimeve.

Operatori ekonomik nuk mund ta tërheqë kuotimin e çmimit të tij pas datës së fundit për dorëzim të tenderëve dhe para skadimit të periudhës brenda së cilës kuotimi i çmimeve është i vlefshëm.

NENI V KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS. VLERËSIMI I KUOTIMIT TË ÇMIMIT

V.1 KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS

Kontratën duhet dhënë operatorit ekonomik që ka dorëzuar:

X [Tenderin e përgjegjshëm, me çmimin më të ulët]; ose

[Tenderin e përgjegjshëm, ekonomikisht më të favorshëm i përcaktuar në bazë të peshës së kriterëve të përshkruara më poshtë]

[vendos kriteret që janë në përputhje me Nenin 50 të ligjit si dhe peshën që ato zënë [zgjidh disa, si në vijim]:

[Çmimi i tenderit]

[kostot e operimit, mirëmbajtjes dhe jetësore]

[data e dërgesës] [periudha e dërgesës] [periudha e përfundimit]

[karakteristikat , funksionale, mjedisore apo të ngjashme me to]

[parashikimi dhe mundësia për shërbime pas shitjes dhe asistencë teknike]

[kushtet e garancisë dhe përjashtimet]

[kushte të tjera ligjore

[

V.2) VLERËSIMI I KUOTIMIT TË ÇMIMEVE

Procesi i vlerësimit të Kuotimit të Çmimit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së Kuotimeve të Çmimeve (proces jopublik) dhe jo më larg se 96 orë pas përfundimit të procesit të hapjes së Kuotimeve të Çmimeve.

Kuotimet e Çmimeve të pranuar **me kohë** që janë dorëzuar nga operatorët Ekonomik do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në bazë të procedurës së përcaktuar në Rregulloren e Prokurimit Publik.

Tenderi konsiderohet të jetë i **përgjegjshëm** kur:

- është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të kësaj dosjeje të tenderit;
- është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në këtë dosje të tenderit;
- është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në paragrafin III.1 të kësaj dosjeje të tenderit.

Të qenët “**në pajtueshmëri**” nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e kërkesave dhe e specifikimeve administrative dhe teknike të parashtruara në këtë dosje të tenderit duke mos u larguar substancialisht nga to dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime.

“**Largime ose kufizime substanciale**” janë ato të cilat esencialisht dallojnë prej termeve dhe specifikimeve të dosjes së tenderit, ndikojnë mbi fushëveprimin, cilësinë ose ekzekutimin e kontratës, kufizojnë të drejtat e autoritetit kontraktues ose obligimet e tenderuesit nën kontratë ose deformojnë konkurrimin për ata tenderues, tenderët e të cilëve janë në pajtueshmëri.

[Kur kontratat përfshijnë shërbimet pas-shitjes dhe/ose trajnimin, duhet të vlerësohet edhe pajtueshmëria teknike e shërbimeve të tilla].

Nëse Kuotimi i Çmimit është dorëzuar nga operatori ekonomik i cili **nuk** përmbush kriteret e përzgjedhjes, të përcaktuara në paragrafin III.1 të kësaj dosjeje të tenderit, Kuotimi i Çmimit menjëherë do të refuzohet dhe nuk mund të bëhet i tillë që të jetë në pajtueshmëri më vonë duke e korigjuar atë ose duke e tërhequr largimin ose kufizimin.

Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e Kuotimeve të Çmimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht sqarim mbi Kuotimin e Çmimit

të tij/saj. Kërkesa për sqarim dhe përgjigjja duhet të bëhen vetëm me shkrim, por nuk guxon të kërkoet, ofrohet ose lejohet asnjë ndryshim në çmim ose në ndonjë kusht ose aspekt material të Kuotimit të Çmimit.

Kuotimet eÇmimeve të **përgjegjshme** do të vlerësohen dhe krahasohen sipas **kritereve për dhënien e kontratës** të përcaktuara në paragrafin V.1 të kësaj dosjeje të tenderit. Tenderuesit i cili ka dorëzuar tenderin e renditur më lartë sipas rezultatit, do t'i jepet kontrata.

V.2.1) KORRIGJIMI I GABIMEVE ARITMETIKE

Autoriteti kontraktues mund t'i korigjojë gabimet plotësisht aritmetike në tender. Gabimet e korigjuara në këtë mënyrë do të jenë të obligueshme për tenderuesin. Tenderuesi menjëherë do të informohet me shkrim për çdo korigjim të tillë.

Gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, gabimet në llogaritjen e çmimit do të korigjohen nga autoriteti kontraktues në këtë mënyrë:

- a) Në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë;
- b) Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korigjohet shuma në total e çmimit njësi;
- c) Në rast se ka gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali i cili vlerësohet të jetë në rregull pas llogaritjes së çmimit për njësi dhe totali i përgjithshëm duhet të korigjohet;

Shumat e korigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për tenderuesin. Në rast se tenderuesi nuk i pranon ato, Kuotimi i Çmimit të tij do të refuzohet. **Në asnjë rast nuk guxon të korigjohet çmimi për njësi.** Në rast se tenderuesi pretendon se ka gabuar çmimin për njësi, Kuotimi i Çmimit të tij do të refuzohet.

NENI V.2.2) [INFORMATA TJERA TË NEVOJSHME]

NENI VI ANKESAT

VI.1) INFORMATAT E PËRGJITHSHME

Sipas Nenit 105.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë (Ligji Nr. 02/L-99, i shpallur me Rregulloren 2007/20), ankesa mund të dorëzohet nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktiviteteve të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që supozohet të ketë bërë shkelje të këtij ligji, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij.

Ankesat duhet të dorëzohen në origjinal te Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), në adresën:

<Rr e Garibaldit ,Prishtinë >

dhe, njëkohësisht, edhe një kopje e ankesës duhet të dorëzohet, në mënyrën më të shpejtë të mundur, te autoriteti kontraktues. Formën standarde të ankesës mund ta gjeni në këtë ueb-faqe: www.ks-gov.net/krpp.

Procedura e ankesave rregullohet sipas dispozitave të PJESËS VIII të ligjit nr. 02/L-99, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë.

VI.2) PERIUDHA KOHORE PËR DORËZIMIN E ANKESËS PRANË ORGANIT TË SHQYRTIMIT TË PROKURIMIT (OSHP)

Ankesa duhet të dorëzohet brenda 8 (tetë) ditësh kalendarike, pas publikimit të Njoftimit të dhënies së kontratës në fjalë. Kjo periudhë fillon pas mesnatës së ditës së publikimit të këtij njoftimi.

Depozitimi i sigurisë së ankesës:

Të gjithë ankuesit duhet të depozitojnë një siguri brenda tri (3) ditëve të punës pas dorëzimit të ankesës. Shuma e këtij sigurimi është e barabartë me pesë për qind (5%) të vlerës së kontratës publike ose konkursit të projektimit, por jo më pak se 1.000 Euro dhe jo më shumë se 5.000 €. Sigurimi i tillë mund të depozitohet në para të gatshme, në formë të një çeku të çertifikuar, kredie ose garancioni bankar (neni 113.1 i ligjit).

Për më shumë detaje në lidhje me mënyrat, vendin dhe shumën e pagesës kontaktoni me personin kontaktues të OSHP-së në adresën e cekur më lartë.

Nëse shuma e plotë e sigurimit në fjalë nuk depozitohet brenda afatit kohor të specifikuar prej tri (3) ditëve të punës, OSHP do të refuzojë ankesën dhe parashtruesi i ankesës nuk mund të parashtrorë më ndonjë ankesë tjetër në të cilën përfshihet ndonjëri nga pretendimet e bëra në ankesën e refuzuar.

Konfiskimi i sigurisë së ankesës:

OSHP-ja do të konfiskojë sigurinë e depozituar nga parashtruesi i ankesës, në qoftë se konstatohet nga paneli shqyrtues se të gjitha pretendimet në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

Nëse paneli shqyrtues konstaton se cilido pretendim i juaji i bërë në ankesë është i rrejshëm, OSHP-ja mund të kërkojë nga ju që të paguani një gjobë shtesë prej 5000 €. Në rast se gjobiteni, do të shpalleni **“i papërshtatshëm”** për pjesëmarrje në cilin do aktivitet prokurimi që mbulohet nga ky ligj, përderisa: (i) gjoba në fjalë nuk paguhet plotësisht; ose (ii) një Gjykatë kompetente e anulon vendimin e OSHP-së për pagimin e gjobës në fjalë.

Kthimi i sigurisë së ankesës:

OSHP-ja, menjëherë do t'ja kthejë sigurimin parashtruesit të ankesës, nëse: a) ankesa e parashtruar, është refuzuar për shkak të mungesës së afateve kohore ose jo plotësisht të saktësuar në nenin 105 dhe 106 të ligjit; dhe b) paneli shqyrtues konstaton se ndonjëra nga pretendimet në ankesë nuk është e rrejshme.

PJESËT E BASHKANGJITURA⁵:

Kësaj dosjeje të tenderit i bashkangjiten <shëno numrin> Aneksat, të cilat formojnë një pjesë të plotë të kësaj dosjeje të tenderit si në vijim:

Aneks Nr.	Përmbajtja	Referim në NENIN e kësaj Dosjeje të Tenderit
Aneks 1	Specifikimet teknike	II.2.3
i obligueshëm Aneks 2	Kërkesat e përshtatshëmrisë: Deklarata nën betim	III.1.1
i obligueshëm Aneks 3	Kërkesa për informacione shtesë	IV.1
Aneks 4	Kriteret për dhënien e kontratës	V.1

Për të larguar aneksin e pashfrytëzuar, vepro si në vijim:

- (1) shtyp Ctrl + Click kur kursori është në Aneksin përkatës,
- (2) fshij (delete) faqen (t) e Aneksit dhe “Section Break” të faqes,
- (3) kthehu tek kjo tabelë,
- (4) selekto rreshtin përkatës që korrespondon me këtë Aneks të fshirë,
- (5) fshij rreshtin –(Table/Delete/Rows)]

⁵ Hiqi aneksat e pa shfrytëzuar.

ANEKS 1:**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Në bazë të Nenit 28 të LPP-02/L-99 të shpallur me Rregulloren Nr. 2007/20

VËREJTJET E PËRGJITHSHME:

Specifikimet teknike përshkruajnë, në një mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme të lëndës (objektit) të kontratës, siç janë:

cilësia	sigurimi i cilësisë
ekzekutimi	terminologjia
kërkesat e projektimit	simbolet
dimenzionet	testimi dhe metodat e testimit
siguria	paketimi, shenjimi, etiketizimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët potencial të interesuar ekonomik.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Artikuli	Specifikimet teknike			AK ⁶
	Nr	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia
1	Paneli komandues I sitemit Fast 2000, testimi dhe servisimi I rregullt, riparimi, programimi, ndërrimi I baterive ,riparimi ipjesev elektronike	Copë	1	
2	Paneli I kontrollit logjik elektro-pneumatik EPSL -2, kontrollimi dhe riparimet e elektronikes	Copë	1	
3	Rimbushja e bonbolave me gaz inergen	Copë	1	
4	Pikmanuale per aktivizim te gazit dhe alarmit.SSM 500dKMI	Copë	1	
5	Sensor optic (zbulues të tymit) 2251 EM	Copë	1	
6	Senzor termik (zbulues të nxehtesis)5251REM	Copë	1	
7	Baza esenzorit optic dhe termik, B501 dhe B501DG	Copë	1	

⁶Mos e përdor këtë kolonë që është e rezervuar për Autoritetin Kontraktues për procesin e vlerësimit.

8	Zëruesi (aparati I alarmit),B/SE 24 dhe B/SE 10	Copë	1	
9	Bateria , 12v,65Ah,tip Rechargeable Battery,Sealed Lead-Acid type,Valave Regulated NP 65-121	Copë	1	
10	Valavola ,tip 188-Suiz Riwk Ledf,KO 2462 526,10-15mA/24VDC total walther	Copë	1	
11	Bereichsventil,DN80 PN 240,HD-BV/3-DN 80,10bar/145psi	Copë	1	
12	Bereichsventil,DN50 PN 240,HD-BV/3-DN 50,10bar/145psi	Copë	1	
13	Gyp Tip.Polyflex 2040-06U 10 ,DN10 3/8,PN 24.0 MPa 3480 psi	Copë	1	
14	Gyp tip manuli 3 TE-8-D/N20021,4Q01	Copë	1	
15	Barometra	Copë	1	

Sqarim: sistemi është specific dhe ofertuesi merr obligimet për rregullimin dhe funksionimin e sistemit duke siguruar edhe te gjitha riparimet e nevojshme dhe pjesë tjera të cila t nuk I kemi perfshire në listë (evitimet e rrjedhave të gazit,komplet elektronika për panelet komanduese,lidhjet e rrjetit të detektoreve,kabllo e instalimit).Ofertuesi duhet të ofroj garancion për secilën pjesë të ndrruar dhe sherbimin ose punen sepse sistemi punon me shtypje të lartë të gazit të inergenit deri në 200bar.Lista duhet të plotësohet me çmi për njësi për secilen pjesë dhe pagesa bëhet në bazë të çmimorese,pjeset ndrohesh vetem në rast defekti.Mirëmbajtja të jetë vjetore dhe pagesa e çmimit të mirëmbajtjes vjetore të bëhet në tri pjesë.

ANEKS 2: KËRKESAT PËR PËRSHTATSHMËRI DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtënëshkruari, duke përfaqësuar: [*operatorin ekonomik që dorëzon, tenderin*] deklaroj nën betim se operatori ekonomik në fjalë përmbush kërkesat për përshtatshmëri të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 02/L-99, neni 61, siç citohet këtu më pas.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në fjalë dhe siguroj se operatori ekonomik në fjalë plotësisht i përmbush këto.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dëmeve nëse operatori ekonomik në fjalë me qëllim apo për shkak të pakujdesisë dorëzon çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri dhe mbiemri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Kërkesat e Përshtatshmërisë
(Sipas nenit 61 të LPP-02/L-99 të shpallur me Rregulloren Nr.2007/20)

- 1. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operatori ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i tij:**
 - a) ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues; ose
 - b) ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të ndonjë pjesë të këtyre të fundit.
- 2 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operatori ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara:**
 - a. është dënuar nga një gjykatë kompetente për veprën penale duke përfshirë praktikumin e korrupsionit, larjen e parave, mitosjen, shantazh ose aktivitetet e përshkruara ose të ngjashme me ato të përshkruara në nenin 117.1 të këtij ligji (shih më poshtë), në ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë ose në cilindo vend, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;
 - b. është deklaruar i papërshtatshëm, për shkak të sjelljeve të përmendura më lart, nga çfarëdo banke, institucioni ose organizate e cila ofron fonde për zhvillim të përgjithshëm, investim publik ose rindërtim;
 - c. është dënuar nga një gjykatë kompetente për veprën penale të pjesëmarrjes në një organizatë kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme;
 - d. është dënuar nga një gjykatë kompetente për veprën penale të mashtrimit ose të barabartë me mashtrimin;
 - e. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale; ose
 - f. është konstatuar nga OSHP-ja ose ndonjë gjykatë kompetente se ka bërë keqprezantim të ndonjë autoritet publik në Kosovë apo gjetiu.
- 3. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operatori ekonomik:**
 - a. gjatë dy viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent; apo aktualisht është objekt procedure (i) për deklarim të falimentimit, (ii) për një urdhër të mbylljes së dhunshme ose administrimi nga një gjykatë, apo (iii) për ndonjë procedurë të ngjashme sipas Ligjit të Kosovës apo ndonjë juridiksioni tjetër;
 - b. me vendim të një gjykatë kompetente është likuiduar ose është vënë në mbikëqyrje të administratorit;
 - c. aktualisht ka një marrëveshje ose aranzhim me kreditorët e tij që siguron kushte të zgjeruara ose të reduktuara të pagimit nëse mbi kushtet e tilla janë pajtuar paraprakisht kreditorët e tillë për shkak se operatori ekonomik më parë ka qenë i paafte që të përmbushë obligimet e tij në afatin e duhur kohor;
 - d. është në një situatë të ngjashme me ato të përshkruara në a, b ose c më lartë, që rrjedhin nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve në vendin ku është themeluar ose në vendin ku zhvillon veprimtarinë e tij afariste;
 - e. aktualisht i nënshtrohet një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon pagesat nga operatori ose për atë operatori ekonomik dhe që rezultojnë në një humbje të tërësishme ose të pjesshme të të drejtave të operatorit ekonomik për të administruar ose disponuar me pasurinë e tij.
 - f. aktualisht është objekt i një vendimi gjyqësor ose procedure administrative që suspendon ose redukton pagesat nga operatori ekonomik ose për operatorin ekonomik; nëse procedurat e tilla gjithashtu mund të rezultojnë në vendimin për falimentimin ose likuidimin e operatorit ekonomik;
 - g. gjatë tri viteve të fundit është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur një kontratë me ndonjë entitet publik, autoritet publik ose ndërmarrje në Kosovë apo diku tjetër;
 - h. aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, apo është vonuar më shumë se tridhjetë (30) ditë me pagesën e ndonjë shume që i ka borxh ndonjë operatori të sektorit publik në Kosovë për ujë, rrymë, gas apo ngrohje;
 - i. aktualisht është me vonesë për pagimin e tatimeve në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose
 - j. ende nuk është pajtuar me një vendim të lëshuar nga OSHP-ja ose një panel shqyrtues.
 - k. Ka një vend biznesi në Kosovë, por nuk ka certifikatë të vlefshme regjistrimi, të lëshuar nga Regjistri i Kosovës i Organizatave të Biznesit dhe Emrave të produkteve.

Ndikimi i Paligjshëm, Ndëshkimet dhe Marrëveshjet Konfidenciale
(Neni 117 i LPP-02/L-99 të shpallur me Rregulloren Nr.2007/20)

117.1. Pa paragjykuar dhe duke iu nënshtuar Ligjit Penal dhe ligjeve të tjera në fuqi, do të konsiderohet shkelje e këtij ligji, e dënueshme dhe e zbatueshme në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit Penal të Kosovës për çdo person që ka pranuar të :

- a. sigurojë, ofrojë, kërkojë, pranojë ose të tregojë gatishmëri për të siguruar, ofruar, kërkuar ose pranuar diç që është e vlefshme (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, para, ofertë pune, pasuri materiale dhe jo-materiale, favorizim ose shërbime) për përfitimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, apo bëhet me qëllim përfitimi të punonjësit ose të ish-punonjësit, zyrtarit ose ish-zyrtarit të një autoriteti kontraktues, a të një personi apo ndërmarrjeje që ka lidhje me punonjësin ose që bashkëpunon me punonjësin, ish-punonjësin, zyrtarin ose ish-zyrtarin, në tërësi ose pjesërisht për të ndikuar ose tentuar për të ndikuar në vendimin ose masat që dëmtojnë, ose lidhen me iniciimin, zbatimin ose rezultatet e aktivitetit të prokurimit;
- b. të ndërmarrë masa, ose të tregojë gatishmëri për të marrë masa, me qëllim të frikësimit, shtrëngimit, dëmtimit ose shkakimit të dëmit (fizik, financiar ose të ndryshëm) të ndonjë personi ose ndërmarrjeje, në tërësi ose pjesërisht me qëllim që të ndikojë, të tentojë të ndikojë ose të hakmerret për një vendim ose veprim lidhur me iniciimin, zbatimin ose rezultatet e aktivitetit të prokurimit;
- c. të kërkojë ose të hyjë në çfarëdo marrëveshje, aranzhim ose mirëkuptim me çfarëdo personi ose ndërmarrje tjetër, nëse marrëveshja, aranzhimi ose mirëkuptimi i tillë ka për qëllim që të ndikojë ose të parandalojë, kufizojë ose të ngatërroj konkurrencën për cilindo kontratë publike; ose
- d. t'ia lehtësojë ose ta inkurajojë cilindo person ose ndërmarrje që të merret me cilindo nga veprimet e specifikuar në pikat "a", "b" ose "c" më lartë.

ANEKS 3: KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË
Në bazë të Nenit 51.1 të LPP-02/L-99 të shpallur me Rregulloren Nr. 2007/20

Për: [emri dhe adresa e autoritetit kontraktues]

DUKE MARRË PARASYSH SE [emri i operatorit ekonomik] (më tej “Operatori Ekonomik”), pas pranimit të dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, beson se nevojiten informacionet shtesë ose informacionet sqaruese si në vijim:

Identifikimi i informacioneve shtesë ose i informacioneve sqaruese, duke përfshirë referimet në NENIN apo në NENET e Dosjes së Tenderit:

PRANDAJ, unë, i poshtënëshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj kërkoj marrjen e informacioneve të identifikuar.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri dhe mbiemri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

ANEKS 4. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS⁴

(tenderi ekonomikisht më i favorshëm)

Në bazë të Nenit 50 të LPP-02/L-99 të shpallur me Rregulloren Nr.2007/20

PËRKUFIZIMI DHE MATJA PËR pjesë [shëno Nr.]

Kategoritë		Përshkrimi i kriterëve	Pesha ⁵	Metoda e Vlerësimit
1	Çmimi	Pesha e çmimit të përcaktohet jo më pak se 50%. Pikët <100x %> për Kuotimin me çmimin më të ulët. Pikët e kuotimit të çmimit llogariten proporcionalisht.	%	$\text{Ç} = \frac{\text{Çu}}{\text{Çt}} \times [100\text{x}\%]$ ⁶
2	[Operimi, mirëmbajtja, dhe shpenzimet e tjera të përditshme]	[Pikët <100x %> për kuotimin e çmimit me shpenzimet më të mira operacionale. Pikët llogariten proporcionalisht (në shpenzime)]	%	$\text{O} = \frac{\text{Om}}{\text{Ot}} \times [100\text{x}\%]$ ⁷
3	[Data e dërgesës, periudha e dërgesës, periudha e përfundimit]	[Pikët <100x %> për kuotimin e çmimit me dërgesën më të shkurtër. Pikët llogariten proporcionalisht (në ditë)]	%	$\text{D} = \frac{\text{Dt}}{\text{Dsh}} \times [100\text{x}\%]$ ⁸
4	[Karakteristikat funksionale]	[Saktësoni] ⁹ [Merr në konsideratë një (ose më shumë) nga karakteristika(t) objektive matëse dhe jepi pikët<100x %> për kuotimin e çmimit me karakteristika(t) më të mira. Pikët llogariten proporcionalisht (me nota).]	%	$\text{K} = \frac{\text{Kt}}{\text{Km}} \times [100\text{x}\%]$ ¹⁰
5	[Shërbimet pas shitjes, ndihma teknike]	[Saktësoni] ¹¹ [Merr në konsideratë një ose (më shumë) nga karakteristika(t) matëse dhe jepi pikët <100x %> për kuotimin me karakteristika(t) më të mira. Pikët llogariten proporcionalisht (me nota)]	%	$\text{N} = \frac{\text{Nt}}{\text{Nm}} \times [100\text{x}\%]$ ¹²
6	[Kushtet e çfarëdo autorizimi ose garancie]	[Pikët <100x %> për Kuotimin e çmimit me kushtet më të gjata të garancisë. Pikët e kuotimi llogariten proporcionalisht (në ditë ose në muaj)]	%	$\text{G} = \frac{\text{Gt}}{\text{Ggj}} \times [100\text{x}\%]$ ¹³
7	Kushte të tjera ligjore			
			100 %	

⁴ Të fshihet ky aneks, kur kriter për dhënie të kontratës specifikohet "tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ultë"

⁵ Pesha e dhënë secilës nga kriteret në fjalë (në % - totali i të gjitha peshave duhet të jetë i barabartë me 100)

⁶ ku Ç_u = Pikët për kuotimin e çmimit, Ç_t = Çmimi më i ulët, Ç_t = çmimi i tenderit.

⁷ ku O_u = Pikët për kuotimin e çmimit, O_s = Shpenzimet më të mira Operacionale, O_t = Shpenzimet Operacionale të Kuotimit të Çmimit.

⁸ ku D_u = Pikët për kuotimin e çmimit, D_{sh} = dërgesa më e shkurtër, D_t = dërgesa e kuotimit të çmimit.

⁹ Nëse disa karakteristika merren në konsideratë, përshkruaj, pesho dhe përcakto metodën e vlerësimit për secilën.

¹⁰ ku K_u = Pikët për Kuotimin Çmimit, K_m = pikët për karakteristikat më të mira, K_t = pikët për karakteristikat e Kuotimit të Çmimit.

¹¹ Mund të jetë numri i pikëve të shërbimit të shitjes në një regjion të specifikuar, ose numri i agjentëve, ose numri i teknikëve, etj...

¹² ku N_u = Pikët për Kuotimin e Çmimit, N_m = Notat më të mira të NT, N_t = notat e NT të Kuotimit të Çmimit.

¹³ ku G_u = Pikët për Kuotimin e Çmimit, G_{gj} = Afati (termi) më i Gjatë, G_t = termi i Kuotimit të Çmimit.

PJESA C

DRAFT¹⁴ KONTRATA

<Emri i Autoritetit Kontraktues> ("Policia e Kosovës"),

dhe

<Emri i Kontraktuesit> (akronimi) ("Kontraktuesi")

janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS: < Mirembajtja vjetore e sistemit të mbrojtjes kunder zjarrit inergen për Laboratorin e Forenzikes të P.K.-së >

Numri i Prokurimit: < P.K.214/10/07/236 >

Neni 1 Ligji i zbatueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-02/L-99. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë.

Neni 2 Lënda

2.1 Lënda e kontratës duhet të jetë [mallrat], [dërgesa], [instalimi], [komisionimi], [mirëmbajtja], [shërbim pas shitjes] në [shëno vendin e dërgesës, afatin kohor të ekzekutimit dhe Inkotermin] nga Kontraktuesi, i [furnizimeve], [shërbimeve] në vijim:

[Përshkrimi i përgjithshëm i [furnizimeve],[shërbimeve] duke përfshirë sasi të]:

2.2 Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik [duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar].

2.3 [Furnizimet të cilat përbëjnë lëndën e kontratës duhet të shoqërohen me pjesë rezervë të përshkruara nga Kontraktuesi në Kuotimin e tij] dhe nga [pajsjet shtesë / artikujt tjerë të nevojshëm për shfrytëzimin e mallrave gjatë një periudhe prej:[.....],siç është e specifikuar në instruksionet për Tenderuesit].

2.4 Vendi i pranimit të [furnizimeve], [shërbimeve] do të jetë [.....], afatet kohore për dërgesën do të jenë [.....] dhe Inkotermin i zbatueshëm do të jetë DDP¹⁵ Periudha e dërgesës do të vazhdojë prej datës së nënshkrimit të kontratës nga ana e të dy Palëve deri [.....].

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i furnizimeve me shifra: _____ €

dhe me fjalë: _____ euro.

3.3 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

3.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës.

Neni 4 Origjina

4.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

¹⁴ Fjala "draft" duhet të largohet nga kontrata kur kjo formë standarde të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit.

¹⁵ DDP - Detyrimi i Dorëzimit është Paguar - Incoterms 2000 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

4.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Që furnizimet të importohen në vendin e Autoritetit kontraktues, duhet të përfshihen të gjitha pagesat dhe tatimet e zbatueshme për importimin e tyre, duke përfshirë edhe TVSH-në.

Neni 6 Dorëzimi

6.1 Dorëzimi i [furnizimeve], [shërbimeve] do të bëhet në kohën, vendin dhe mënyrën siç është specifikuar në dosjen e tenderit dhe në kushtet e kontratës.

6.2 [saktësoni periudhën e fillimit të ekzekutimit]

6.3 Kontraktuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin e përkohshëm në destinacion. Furnizimet duhet të paketohen në atë mënyrë që të parandalohet dëmi ose keqësimi i tyre gjatë transportit deri në destinacion.

6.4 [Saktësoni ndonjë kërkesë specifike të paketimit]

Neni 7 Variacionet

7.1 Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën që, në kohën e kontraktimit, t'i ndryshojë sasinë e parapara në Kushtet e veçanta. Vlera totale e furnizimeve mund të mos rritet dhe as të bjerë si rezultat i variacionit të sasive për më tepër se [10 %] të çmimit të kontratës. Çmimet e njësisë që janë përdorur në ofertë do të zbatohen edhe për sasinë e prokuruar me variacion.

Neni 8 Cilësia e furnizimeve

8.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

8.2 [Tregoni këtu dokumentet që duhet të sigurohen dhe nëse ka nevojë, procedurën e përdorur nga Autoriteti kontraktues]

Neni 9 Garancia

9.1 Kontraktuesi duhet të garantojë që furnizimet janë të reja, të papërdorura, të modelit më të fundit dhe që inkorporojnë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe në material. Kontraktuesi do të garantojë edhe se asnjë nga furnizimet nuk kanë asnjë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria.

9.2 Garancia do të mbetet valide për [12] muaj, pas pranimit të [furnizimeve], [shërbimeve].

Neni 10 Vonesat e ekzekutimit

10.1 Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrinë t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.

Neni 11 Inspektimi dhe testimi

11.1 Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimit apo në vendet që janë specifikuar në Kushtet e veçanta.

11.2 [shtësoni vendet/mallrat që do të inspektohen dhe testohen dhe marrëveshjet praktike për testim]

11.3 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Kontraktuesit.

11.4 Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

- 11.5** Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen.
- 11.6** Furnizimet do të pranohen nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit.

Neni 12 Nën-kontraktimi

- 12.1** Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 5 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Nuk mund të nënkontrakttoj më tepër se 40 % të vlerës së kontratës.

Neni 13 Pagesat

- 13.1** Pagesat do të bëhen në euro. Autoriteti kontraktues do t'i paguajë Kontraktuesit shumën e obligimit brenda [30] ditësh pas datës në të cilën është regjistruar pagesa e pranueshme.

Neni 14 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

- 14.1** Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Kontraktuesit **shtatë ditë** paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur kontraktuesi nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d). Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Kontraktuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës; i) Nuk arrinë të jap garancinë për funksionim të mirë të mallrave.

Neni 15 Ndërprerja nga ana e Kontraktuesit

- 15.1** Kontraktuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues **14 ditë** paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Kontraktuesit shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) E pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se [180] ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Kontraktuesit.

Neni 16 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

- 16.1** Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda [30] ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.
- 16.2** [saktësoni Gjykatën Kompetente, ose Organin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve].

Neni 17 Komunikimet

- 17.1** Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

E hartuar në gjuhën [shqipe] dhe [serbe] dhe [angleze] ¹⁶në tri origjinale, dy për Autoritetin Kontraktues dhe një për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:		Emri:	
Pozita:		Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

¹⁶ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në këtë tender.

PJESA C

FORMULARI I KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Për: <Policia e Kosovës, Prishtinë >

(në tekstin e mëposhtëm "Autoriteti kontraktues")

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit me Numër të Prokurimit: <P.K.214/10/07/236 > të datës:<07.09.2010>. **Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.**
2. **Kuotimi ynë i çmimeve përfshin këto dokumente:**
 - (i) Këtë Formular të kuotimit të çmimeve të plotësuar me çmimet dhe të nënshkruar nga ana jonë.
 - (ii) Përshkrimin e lëndës së kontratës, që përfshin:
 - (a) Informata mbi natyrën, fushëveprimin, sasinë;
 - (b) [Indikacion i artikullit (artikujve) që mbulohe nga ky kuotim i çmimit];
 - (c) Specifikimet teknike të artikujve të ofruar;
 - (d) Kushtet e dërgesës që ofrohen;
 - (e) Kushtet e garancisë që ofrohen.
3. **Çmimi total i Kuotimit [duke mos e përfshirë zbritjen e përshkruar në pikën 4] është:**
Gjithësej çmimi i Kuotimit me shifra:.....€
dhe me fjalë:.....Euro.
4. **Ne do të japim një zbritje prej [....%], ose [.....] në rast se neve na jepet kontrata.**
5. Ky Kuotim është valid për një periudhë prej: [.....] nga data finale për dorëzim të Kuotimit, dmth deri me datë: [../...../.....].
6. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim , mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK.
7. **Çmimi total i kuotuar është fiks dhe nuk i nënshtrohet asnjë korrigjimi gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).**
8. **Çmimi total i kuotuar specifikohet në Specifikimin e Çmimeve të bashkangjitur.**

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri dhe mbiemri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

1. LISTA E DOKUMENTEVE TË KËRKUARA

Referencat vijuese janë **të obligueshme** për një kuotim të Çmimit të vlefshëm.

Operatorët ekonomik duhet të kontrollojnë nëse dokumentet në listë, të plotësuara dhe të nënshkruara në mënyrën e duhur, janë të përfshirë në kuotimin e çmimit të tyre.

Për operatorët ekonomikë:	LISTA E DOKUMENTEVE TË KËRKUARA	
Për autoritetin kontraktues:	LISTA E PLOTË E KËRKESAVE FORMALE/ADMINISTRATIVE PËR KUOTIMET E ÇMIMEVE¹⁷	
Formulari i Kuotimit të Çmimit të plotësuar dhe i nënshkruar në mënyrën e duhur.		x
Dëshmitë e dokumentuara mbi përshtatshmërinë:		
Deklarata nën betim se tenderuesi përmbush kërkesat e përshtatshmërisë të nenit 61 të LPP-02/L-99.		x
Deklarata e nënshkruar nga Administrata Tatimore në vendin e themelimit të operatorit ekonomik se operatori ekonomik nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve, së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë ose para datës së dorëzimit të ftesës për Kuotimin e Çmimit.		x
[Dokumente tjera dëshmi (specifiko)]		
Dëshmitë e dokumentuara të kualifikimit:		
Deklaratë e nënshkruar nga autoriteti i duhur publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës, ose nëse nuk është e mundur, një deklaratë nën betim lidhur me atë regjistrim.		x
[Dëshmi të autorizimit, licencës ose anëtarësisë organizative të operatorit ekonomik ose nëse nuk është e mundur, një deklaratë nën betim lidhur me dëshmitë në fjalë]		x
[Ndonjë kërkesë tjetër për dokumente:		
[specifiko]:		

¹⁷ Autoriteti kontraktues do të kontrollojë nëse të gjitha dokumentet e kërkuara janë dorëzuar sipas listës në fjalë dhe se nuk është bërë asnjë modifikim në lidhje me kushtet e dosjes së tenderit nga operatorët ekonomik që kanë dorëzuar Kuotimin e Çmimit.

Shtojcë e Formularit për Kuotimin e Çmimeve: SPECIFIKIMI I ÇMIMEVE

Artikulli Nr. ¹⁸	Përshkrimi	Njësia matese	Sasia	Çmimi për njësi DDP ¹⁹ - €	Totali
1	Paneli komandues I sitemit Fast 2000, testimi dhe servisimi I rregullt, riparimi, programimi, ndërrimi I baterive , riparimi i pjesëve elektronike	Copë	1		
2	Paneli I kontrollit logjik elektro-pneumatik EPSL -2, kontrollimi dhe riparimet e elektronikës	Copë	1		
3	Rimbushja e bonbolave me gaz inergen	Copë	1		
4	Pikmanuale për aktivizim të gazit dhe alarmit. SSM 500dKMI	Copë	1		
5	Sensor optic (zbulues të tymit) 2251 EM	Copë	1		
6	Senzor termik (zbulues të nxehtësisë) 5251REM	Copë	1		
7	Baza esenzorit optic dhe termik, B501 dhe B501DG	Copë	1		
8	Zëruesi (aparati I alarmit), B/SE 24 dhe B/SE 10	Copë	1		
9	Bateria , 12v, 65Ah, tip Rechargeable Battery, Sealed Lead-Acid type, Valave Regulated NP 65-121	Copë	1		
10	Valavola , tip 188-Suiz Riwk Ledf, KO 2462 526, 10-15mA/24VDC total walther	Copë	1		
11	Bereichsventil, DN80 PN 240, HD-BV/3-DN 80, 10bar/145psi	Copë	1		
12	Bereichsventil, DN50 PN 240, HD-BV/3-DN 50, 10bar/145psi	Copë	1		
13	Gyp Tip. Polyflex 2040-06U 10 , DN10 3/8, PN 24.0 MPa 3480 psi	Copë	1		
14	Gyp tip manuli 3 TE-8-D/N20021, 4Q01	Copë	1		
15	Barometra	Copë	1		
Shuma e përgjithshme					

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)

Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri dhe mbiemri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

¹⁸ Të shtohen rreshta me numër rendor aq sa është e nevojshme.

¹⁹ Detyrimi i Dorëzimit është Paguar - Incoterms 2000 Oda Ekonomike Ndërkombëtare.

